



KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

**RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT
TË MINISTRISË SË DREJTËSISË
2021**

www.drejtesia.gov.al

Përmbledhje Ekzekutive

Qasja vlerësuese

Metodologjia e monitorimit

Gjetjet e raportit

Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e

Drejtësisë

Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së

Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun

Konkluzione dhe rekomandime

Hapa të tjera

Aneks

Lista e shkurtesave

AB	Auditi i Brendshëm
BNJ	Burime Njerëzore
DRÇD	Drejtoria Rregullatore për Çështjet e Drejtësisë
DPSD	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në fushën e Drejtësisë
DPKHL	Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit
DMJBN	Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale dhe Bashkëpunimit Ndërgjyqësor
DPPD	Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë
DPPAK	Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën e Antikorrupsionit
MD	Ministria e Drejtësisë
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
PI	Plan Integriteti
PT	Programi i Transparencës
PSV	Procedura Standarte Veprimi
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Prioritizimi i kuadrit antikorrupsion është jetësuar së fundi nëpërmjet: forcimit të kompetencave dhe kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit; koordinimit dhe zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, si edhe të forcimit të kuadrit rregullator dhe të mekanizmave të integritetit në administratën publike.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe eficencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative. Vendosja e planit të integritetit dhe sigurimi i zbatimit të tij përbën një *approach* që garanton masat antikorrupsion dhe një mundësi të shtuar të suksesit të zbatimit të tyre.

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, është përgjegjëse dhe koordinuese për objektivat A.8 dhe A.9 të SNKK-së, që materializojnë forcimin e integritetit në administratën publike. Në zbatim të këtyre objektivëve, gjatë vitit 2020, Ministria e Drejtësisë hartoi dhe miratoi për së pari, dy instrumente me karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit: Planin e Integritetit të institucionit, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.333, datë 07.10.2020; dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020, me zbatimin e të cilës do të mundësonte replikimin e planeve të integritetit të institucionet e tjera të administratës qendrore me kompetenca ekzekutive, përkatësisht ministritë fillimisht dhe varësitë e tyre në vijim.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, Ministria e Drejtësisë hartoi Instrumentin e Monitorimit të Planit të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.553, datë 30.09.2021. Ky dokument shërben si një udhëzues për procesin e monitorimit të zbatimit të planeve institucionale të integritetit, e cila për së pari gjithashtu është aplikuar në këtë ministri, si një model i mirë zhvillimi dhe që produkt i parë është ky raport monitorimi.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuara në 12 fusha të përgjegjësisë institucionale të ministrisë. Plani i Integritetit përmban gjithsej 112 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2023.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2021, është i pari dokument i hartuar që prej miratimit të Planit të Integritetit. Në përputhje me kreun 3, pika 3.1 të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Drejtësisë ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2021, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, përmban të dhëna për veprimtarinë operacionale të njësive (drejtorive) të brendshme kontribuuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.


Për vitin 2021, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 63 masa/aktivitete, të shpërndara në tre objektiva, përkatësisht:

Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e Drejtësisë

Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun

Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 63 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2021, rezulton se: janë zbatuar 40 masa/aktivitete, në proces zbatimi kanë mbetur 16 masa/aktivitete dhe të pazbatuara¹ 7 masa/aktivitete.



¹Në këto të dhëna janë përfshirë dhe masa/aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim.

Gjatë vitit 2021, Ministria e Drejtësisë pati një ndryshim stukture dhe organike, të miratuar e urdhërin e Kryeministrit, Nr.128, datë 08.11.2021, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”. Ky akt solli një ndryshim thelbësor në organizimin e institucionit, gjë e cila ndikoi edhe në ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit, referuar masave dhe aktivitetet të objektivit 2 të tij, që lidhen me plotësimin e vendeve të lira në njësitë (drejtoritë) teknike të ministrisë, përshkrimet dhe elementët teknikë të kryerjes së punës, hartimin e hartës së proceseve të punës.

Gjatë vitit 2021, masa dhe aktivitet e lidhura me përditësimin e rregullores së institucionit u realizuan dhe u përfshinë në tekstin e saj, në pritje për tu miratuar me urdhër të ministrit. Përmendim, këtu kuadrin e plotë rregullator për etikën dhe integritetin, si dhe ndërhyrjet dhe reflektimet rregullore të strukturave teknike të institucionit si dhe ndërhyrjet në dispozitat e Rregullores së Brendshme për konfliktin e interesave privatë, dhuratat dhe sponsorizimet, lobistët, veprimtari të jashtme, sinjalizimin si dhe rregullimin e komunikimit ndërmjet strukturave teknike të brendshme dhe gjithashtu me grupe jashtë institucionit.

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raporteve të performancës dhe ato të auditimit (të brendshëm dhe të jashtëm). Programi i Transparencës një format i rishikuar dhe një dritare informacioni për aktivitetin e brendshëm të ministrisë duhet të përmendet si një *milestone* i kryer dhe realizuar në kohë.

Ky raport monitorimi evidenton gjithashtu nga ana tjetër plotësisht nevojën për angazhim më të madh të strukturave dhe kapaciteteve teknike të ministrisë në zbatim të parashikimeve të bëra për të mundësuar një performancë më të mirë institucionale, siç janë ngritja dhe pasja e hartës së proceseve të punës dhe rekrutimi i plotë i punonjësve ku evidentohen vakanca.

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit në MD, të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 7 drejtorive dhe strukturave teknike në Ministrinë e Drejtësisë, të një grupi të brendshëm pune dhe të koordinatorit të së drejtës së informimit, një funksion i përcaktuar në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, për të cilat ka pasur të parashikuar masa për zbatim për vitin 2021. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të

kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinator² i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinator i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme (referohu: seksioni Nr. 2.2.6 të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet qendrore).

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuuese në këtë raport, të cilat janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave në Fushën e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore në Fushën e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo maë të parashkuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumenta të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; të dhëna për buxhetin; rekomandime dhe konkluzione.

Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Gjetjet e Raportit

Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e

Drejtësisë

Përmes këtij objektivi synohet përmirësimi dhe forcimi i integritetit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator (rregulla dhe


² Koordinator i Integritetit është përfaqësues i Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion.

procedura) për çështje të veçanta të integritetit si dhe gjithashtu të nxjerrjes dhe përmirësimit të kuadrit të brendshëm institucional në menaxhimin e integritetit në institucional.

Ky objektiv përmban një numër prej 17 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit si: Kodi i Etikës, deklarimi i interesave private, dhurata, donacione, sponsorizime, takime me grupe interesi, njësia e sinjalizimit, linjat e komunikimit institucional, manuali i hartimit të ligjeve.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e drejtorisë së burimeve njerëzore dhe të drejtorisë së kodifikimit dhe harmonizimit të legjislacionit. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 8 masa të zbatuar plotësisht, 8 në proces zbatimi, 3 të pazbatuara (në aneksin e raportit: masa 1.1.1 (8), 1.1.2, 1.5.2).

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Kuadër rregullator për integritetin	Masa/ Aktivitete	17	8	6	3



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2021*, vijon të mbetet në proces realizimi (finalizimi) kuadri rregullator për etikën dhe integritetin si edhe miratimi i rregullores së re të Ministrisë së Drejtësisë. Është hartuar projekti për Kodin e Ri të Etikës nga njësia përgjegjëse në MD dhe me parashikime specifike në të, për rregulla të integritetit, rregulla të konfliktit të interesit dhe

deklarimeve të interesave private, të sinjalizimeve si mekanizma antikorrupsioni, të deklarimit të dhuratave, sponsorizimeve, takime me lobistë dhe/apo pjesëmarrjes në veprimtari të jashtme, të cilat janë klasifikuar në statusin e zbatimit pjesërisht zbatuar, për shkak të mosmiratimit final të rregullores së MD brenda vitit 2021.

Linjat e komunikimit strukturor së brendshmi, dhe njësitë dhe funksionet e tjera si koordinatori i të drejtës së informimit apo të konsultimit publik janë parashikuar plotësisht në draft rregulloren e re të MD, në pritje të miratimit përfundimtar.

Është kryer plotësisht vetëdeklarimi i punonjësve/stafit të MD nëpërmjet mekanizmave të memove informuese për angazhimin në veprimtari të jashtme sipas parashikimeve të ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 714, date 22.10.2004 “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”, si dhe është miratuar rregullorja e Konfliktit të Interesave (Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.09, datë 13.01.2020).

Mbetet në proces hartimi i dokumentit të politikës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjatë këtij viti, struktura teknike e sektorit të Burimeve Njerëzore, ka ndjekur trajnime të organizuara nga ASPA, mbi procedurat dhe rregullat e parandalimit të konfliktit të interesit si edhe informimi i stafit të ministrisë mbi rregullat e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe mbi administrimin e regjistrit përkatës. Është i kryer rregullisht plotësimi i deklaratës së konfliktit të interesit nga ana e punonjësve në të gjitha rastet e procedura të prokurimit të kryera.

Koordinatori i të drejtës së informimit, gjatë vitit 2021, ka rezultuar një emërim i qëndrueshëm, dhe kapacitetet e tij janë rritur nëpërmjet pjesëmarrjeve në trajnime të ofruar nga ASPA, siç përmendet seanca “Prezantimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale i përafruar me EU ACQUIS”.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


■ **Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit**

Përmes këtij objektivi synohet mirëfunksionimi i administratës të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet vendosjes së linjave të qarta hierarkike, sanksionimit të një procedure të qartë të të gjitha proceseve të punës në njësitë e ministrisë, forcimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale të fushës por edhe rekrutimin e stafit në mungesë në përputhje me strukturën dhe organikën në fuqi të ministrisë.

Ky objektiv përmban një numër prej 35 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht hartimit të proceseve të punës (hartës); plotësisht të vakancave në sektorë dhe drejtori të MD; forcimit të kapaciteteve profesionale.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e drejtorisë së burimeve njerëzore dhe të drejtorive të tjera teknike në MD. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 23 masa të zbatuar plotësisht, 8 në proces zbatimi, 4 të pazbatuara (në aneksin e raportit: masa 2.4.2, 2.5.2, 2.9.2, 2.13.1).

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuar
Burime njerëzore të qëndrueshme dhe të kualifikuara	Masa/ Aktivitete	35	23	8	4



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2021*, është miratuar struktura dhe organika e Ministrisë së Drejtësisë (urdhër i Kryeministrit, nr. 128, datë 8.11.2021), e cila solli ndryshime në numrin total të punonjësve të MD dhe si rezultat edhe rishikimi i përshkrimeve të punës mbetet në proces, në të gjitha drejtoritë e MD si dhe gjithashtu hartimi/shkrimi i hartës së proceseve të punës.

Është bërë bërë planifikimi i nevojave për pranim për të gjitha njësitë dhe drejtoritë e MD, dhe dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike, por pa u arritur të kryhen procedura finale

të rekrutimit. Brenda muajit Dhjetor 2021, kanë filluar procedurat e shpalljes në DAP të vendeve të lira (vakanca) për Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion. Këto shpallje janë të publikuara në link:

<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3382>

<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3364>

<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3363>

<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3356>

<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3355>

<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3354>

<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3338>

Janë zbatuar procedurat e zëvendësimit të përkohshëm të pozicionit të drejtorit të Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsionit në atë të Drejtorit të Përgjithshëm të Antikorrupsionit.

Gjatë këtij viti, është miratuar organika për Drejtorinë e Auditimit pa sjellë ndryshime në strukturë (pakësim apo shtim të numrit të punonjësve). Struktura e drejtorisë përbëhet nga 4 specialistë dhe drejtori. Në këtë drejtori nuk ka vende vakante me përjashtim të pozicionit të drejtorit, i cili deri brenda vitit 2021 është duke u kryer me ngarkim detyrash nga persona staf i drejtorisë.

Audituesit e brendshëm të MD janë staf të certifikuar si auditues të brendshëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht që prej viteve 2008, 2019 e 2021. [Në faqen zyrtare të MFE mund të gjendet e publikuar lista e plotë e audituesve të brendshëm, https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2021/10/Rregjistri-AB-2005-2021.pdf](https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2021/10/Rregjistri-AB-2005-2021.pdf)

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, janë zhvilluar seanca trajnimi për stafin e Drejtorisë së Projekteve IPA, përkatësisht:

- 1- Webinar: Projekti i Asistencës Teknike nga BE “Fuqizimi i Menaxhimit të Financave Publike”, ka organizuar seminarin virtual të radhës për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale (MBS), më datat 7 dhe 9 prill 2021, nëpërmjet platformës Webex, dhe
- 2- 16-17-18 shtator 2021 u zhvillua në Gjirokastrë workshopi me temë “*Budget Support multi-stakeholder*”, në të cilën është raportuar edhe mbi ecurinë e deritanishme të Kontratës Sektoriale “BE për Reformën në drejtësi”.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

■ **Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së**


Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun

Përmes këtij objekti synohet rritja dhe përmirësimi i transparencës dhe veprimtarisë së institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, kundrejt grupeve të interesit dhe publikut nëpërmjet zbatimit dhe përdorimit të instrumenteve të të drejtës së informimit, konsultimit publik, të tjera forma të bashkëveprimit aktiv institucion-të interesuar.

Ky objektivi përmban një numër prej 11 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht transparencës dhe informimit të publikut mbi aktivitetin dhe performancën e Ministrisë së Drejtësisë, gjatë vitit 2021.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë kryesisht strukturat që prodhojnë raporte apo janë subjekt i auditimeve dhe kontrolleve, si dhe funksionet e koordinatorit të drejtës së informimit dhe ai i konsultimit publik. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 9 masa të zbatuar plotësisht, 2 në proces zbatimi.

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuar
Transparenca e MD	Masa/ Aktivitete	11	9	2	-



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2021*, objektivi 3 ka shënuar arritje shumë të mira në funksion të rritjes së transparencës dhe konsultimit publik.

Në totalin prej 11 masash (aktivitetesh) për tu realizuar, në kuadër të publikimeve dhe të vënies në dispozicion të publikut të gjerë të informacioneve dhe raporteve me natyrë financiare, kontrolli dhe/apo auditimi të Ministrisë, të kontratave publike që kryen dhe ndërmer institucioni. Këto akte janë të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme për të interesuarit përkatësisht në linqet: <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti-perfundimtar-i-KLSH-per-auditimin-Janar-Tetor-2019.pdf>; <https://drejtesia.gov.al/raportime/>

<https://drejtesia.gov.al/zbatimi-dhe-monitorimi-i-kontratave/>.

Gjithashtu, MD gjatë 2021 ka qenë plotësisht transparente dhe ka publikuar aktet për procedurën për të bërë kërkesa, ankesa, vërejtje dhe sinjalizime në institucion, link: <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/Mbi-konsultimin-publik.docx> , dhe gjithashtu rregulloren e brendshme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, e cila mund të gjendet në link: https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/RREGULLORE_BRENDSHME_PER_SINJALIZUESIT.pdf

Kodi i Etikës së institucionit është i publikuar në: <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Kodi-i-Etikes-i-MD.pdf> .

Programi i Transparencës është riformatuar dhe publik dhe funksional në ofrimin e informacioneve, link:

<https://drejtesia.gov.al/planin-vjetor-te-konsultimit-publik-2021/> dhe <https://drejtesia.gov.al/programi-i-transparences-ne/>.

Ndryshimi dhe hartimi i rregullores së brendshme të institucionit mbetet në proces, dhe përkatësisht dy masat për: rregulla mbi ndërveprimin ndërmjet njësive të MD-së dhe Koordinatorit për të Drejtën e Informimit si dhe rregullave të brendshme të institucionit për ndjekjen nga ana e qytetarëve të mbledhjeve që ai kryen, përpara shqyrtimit apo miratimit të akteve për konsultim, janë në gjendjen e realizimit në proces gjatë vitit 2021.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit. Viti 2021, ishte viti i parë i zbatimit të këtij plani integriteti në Ministrinë e Drejtësisë, vit gjatë të cilit u hasën edhe disa vështirësi që patën ndikimin e tyre mbi ecurinë e zbatimit të tij, sipas parashikimeve të bëra dhe afateve

konkrete. Një strukturë e re organizative e Ministrisë së Drejtësisë e miratuar vetëm në 3-mujorin e fundit të vitit 2021, ndryshimet referuar strukturës institucionale dhe organikës së ministrisë, mjedisit rregullator, partneritetit dhe angazhimit nga ana e të gjithë njësive teknike afektuan zbatimin e plotë të këtij instrumenti.

Pengesat e ardhura edhe si pasojë e pandemisë Covid-9, gjatë vitit 2021, patën gjithashtu ndikimin e tyre në zhvillimin e disa prej aktiviteteve, kryesisht ato të lidhura me aktivitete për forcimin e kapaciteteve të stafit të ministrisë.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar-dhjetor 2021*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Ministria e Drejtësisë ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit.
- Njësitë (drejtoritë) teknike të ministrisë kanë shënuar përparime kryesisht në forcimin e kapaciteteve të stafit, të stafit të ri të rekrutuar, në rishikimin e strukturës dhe në fillimin nga hartimi të paketës së plotë të kuadrit të etikës, integritetit dhe të instrumenteve e mekanizmave rregullatore antikorrupsion.
- Miratimi i një strukture dhe organike të re të Ministrisë së Drejtësisë, të miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.128, date 08.11.2022 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë", vjen në përputhje me evidentimin e të reja që kjo ministri ka për zbatim (fusha e përgjegjësisë së saj).
- Është rishikuar dhe hartuar manuali i ri i hartimit të akteve, pjesë e të cilit është edhe vlerësimi i hapësirave të legjislacionit për korrupsion (*corruption proofing of legislation*).
- Garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.drejtesia.gov.al.

Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në planin e veprimit;
- Të miratohet rregullorja e re e institucionit, si një detyrë që vjen nga ky plan integriteti, (e miratuar tashmë në TM 1 2022) dhe të bëhet publikimi i saj në faqen e internetit të MD;
- Të bëhet informimi/kryerja e trajnimeve të brendshme të stafit të MD-së për rregullat e integritetit (Kod Etike dhe rregullat e tij);
- Të trajnohen punonjësit përkatës në MD në lidhje me këtë metodologjinë e re të hartimit të akteve/legjislacionit;
- Të plotësohen vakancat në ministri në të gjithë strukturat ku rezultojnë;
- Të vijohet me hartimin e hartës së proceseve të punës;
- Të parashikohen rregulla për procesin e derregullimit në rregulloren e brendshme.

Aneks

- Aneksi i raportimit të informacionit nga njësité kontribuuese